

**KËSHILLAT LOKALE PËR PARANDALIMIT PËR
BASHKËPUNIM TË PËRFORCUAR LOKAL**

LEKSIONET E MËSUARA

Botuesi:
Eurothink - Qendra për Strategji Europiane

Redaktor:
Dimitar Nikollovski

Autorë:
Aleksandar Stojanovski, Frosina Krushkarovska, Dimitar Nikollovski

Dizajni grafik:
Sashka Deskoska

Përkthimi Maqedonisht - Shqip:
Behar Rushit

Titulli origjinal:
„Локални совети за превенција за засилена соработка: Научени лекции“

tetor, 2023
Shkup

Ky projekt mbështetet nga Ambasada e ShBA-së. Mendimet, gjetjet dhe konkluzionet ose rekomandimet e shprehura këtu janë të zbatuesve/autorëve dhe nuk i pasqyrojnë ato të Qeverisë së ShBA-së.

TABELA E PËRMBAJTJES

04

KORNIZA E PARAQITJES SË KËSHILLAVE LOKALE PËR PARANDALIM NË
REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

06

RËNDËSIA E KËSHILLAVE LOKALE PËR PARANDALIM

07

PËR AKTIVITETET E PROJEKTIT

10

GJETJET DHE LEKSIONET E MËSUARA

16

MATRICA ME INDIKATORË TË VETËVLERËSIMIT PËR PUNËN
E KËSHILLAVE LOKALE PËR PARANDALIM

18

KONKLUZIONI

19

REFERENCAT

KORNIZA E PARAQITJES SË KËSHILLAVE LOKALE PËR PARANDALIM NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Pas konfliktit ushtarak në vitin 2001 në Maqedoninë e Veriut, në kuadër të programit policor dhe Njësisë për zhvillimin e policisë pranë Misionit të OSBE-së në Shkup, u theksua nevoja për themelimin e këshillave lokale për parandalim (KLP). Qëllimi i tyre është përfshirja aktive e faktorëve relevant në procesin e ballafaqimit me sfidat dhe problemet me të cilat përballen qytetarët në bashkësitë e tyre lokale si dhe për të mundësuar cilësi më të mirë të jetës.

Pas konfliktit ushtarak në vitin 2001 në Maqedoninë e Veriut, në kuadër të programit policor dhe Njësisë për zhvillimin e policisë pranë Misionit të OSBE-së në Shkup, u theksua nevoja për themelimin e këshillave lokale për parandalim (KLP). Qëllimi i tyre është përfshirja aktive e faktorëve relevant në procesin e ballafaqimit me sfidat dhe problemet me të cilat përballen qytetarët në bashkësitë e tyre lokale si dhe për të mundësuar cilësi më të mirë të jetës.

Këshillat lokal për parandalim filluan të themelohen në vitin 2002 në shumicën e komunave të vendit. Ideja e këtyre këshillave vendore është të përfaqësojnë organe për veprim të përbashkët të palëve të interesuara dhe faktorëve përkatës në fushën e sigurisë publike në nivel lokal, për zbatimin efikas të aktiviteteve që synojnë zgjidhjen e sfidave dhe problemeve lokale si dhe mjet për të nxitur zbatimin e konceptit “policia në komunitet”.

Baza për themelimin e tyre gjendet në Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale dhe Ligjin e Policisë. Para së gjithash, është e rëndësishme të theksohet se në praktikë KLP nuk janë të rregulluara në legjislacionin nacional. Neni 25 i Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale nuk parasheh obligim ligjor për formimin e detyrueshëm të këshillave lokale për parandalim, por pranohet rëndësia e qytetarëve në vendosjen për çështje me rëndësi lokale. Prandaj, pavarësisht mungesës së obligimit ligjor për të formuar KLP, nuk ka dyshim rëndësia e njohjes së tyre nga pushteti vendor si mjet thelbësor për zhvillimin e qasjes gjithëpërfshirëse në ndërtimin e një mjedisi të sigurt për jetesë¹. Gjithashtu, neni 11 i Ligjit për Policinë² parasheh bashkëpunimin e policisë me qytetarët, me organet shtetërore dhe me shoqatat e qytetarëve.

Për të arritur bashkëpunimin dhe për të mundësuar përforcimin e ndikimit të publikut në punën e policisë (paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni), mund të formohen organe këshillëdhënëse dhe koordinuese (këshilla dhe komisione), për të ndërtuar rekomandime të përbashkëta dhe të vendosen marrëdhënie partneriteti ndërmjet qytetarëve dhe policisë për të përmirësuar sigurinë publike në pjesën e një komune të caktuar dhe për t'i parandaluar me sukses incidentet që ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë e qytetarëve dhe komunitetit.

Eurothink, në periudhën dhjetor 2021 - janar 2022, ka realizuar hulumtim³ për përfaqësimin e KLP në komunat e Maqedonisë së Veriut përmes kërkesave për qasje në informacione drejtuar komunave. Rezultatet kanë treguar se 31 komuna kanë KLP të themeluar dhe funksionale, 18 komuna kanë KLP të themeluar por joaktive, 16 komuna nuk kanë KLP të themeluar dhe një komunë është në proces të formimit të KLP. Për më tepër, 12 komuna nuk i janë përgjigjur kërkesës për qasje në informacione kurse 3 komuna nuk kanë pranuar kërkesë për qasje në informacione për funksionimin e KLP.

Lidhur me njohjen e publikut me konceptin e KLP, hulumtim i mendimit publik i publikuar nga Eurothink kurse i kryer në dhjetor 2022⁴ ka treguar se 10% e të gjithë të anketuarve janë të njohur me rolin dhe punën e KLP në komunën e tyre, që është rritje prej 5 % krahasuar me vitin 2021. Në të njëjtën kohë, të anketuarit më të rinj dhe ata me arsim të lartë janë të njohur me rolin dhe punën e KLP në përqindje më të lartë.

RËNDËSIA E KËSHILLAVE LOKALE PËR PARANDALIM

Këshilli Lokal i arandalimit është organ për veprim të përbashkët të faktorëve dhe palëve përkatëse në fushën e sigurisë publike në nivel lokal, si dhe zbatimin me sukses të konceptit të “policisë në komunitet”. Ai lidh të gjitha subjektet kyçe në një bashki që mund të ndikojnë në cilësinë e jetës së qytetarëve, duke mundësuar shqyrtimin e sigurisë dhe problemeve të tjera lokale përmes një prizmi multidisiplinar, bazuar në shkaqe të shumta të ndërlidhura dhe të ndjeshme ndaj praktikave të ndryshme të ndërhyrjeve.

Nga pozita e vetëqeverisjes lokale, këshillat lokale janë mjet që duhet t’i mbledhin në një tryezë të përbashkët të gjitha institucionet dhe palët e interesuara që marrin pjesë në proceset dhe procedurat administrative shoqërore, të cilat zhvillohen në mjediset lokale ku kanë kompetencë. Nga këndvështrimi policor, KLP duhet të rretizojë të gjitha subjektet kyçe që do të “ndihmojnë” policinë në kryerjen e aktiviteteve të saj parandaluese, gjegjësisht të ndihmojnë policinë që të jetë proaktive në zgjidhjen e problemeve të sigurisë së qytetarëve dhe në ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike. Gjatë zgjidhjes së problemeve, KLP duhet të marrë parasysh nevojat e ndryshme në komunitet, veçanërisht ato që lidhen me grupet shoqërore të marginalizuara dhe të jo mjaftueshëm të përfaqësuara.

PËR AKTIVITETET E PROJEKTIT

Thirrje për përzgjedhjen e komunave për përfshirje në projekt

Projekti “Këshillat lokale për parandalim për bashkëpunim të përforcuar lokal” është zbatuar në periudhën prej 1 shtator 2022 deri 30 shtator 2023. Aktivitetet e projektit, bazuar në rezultatet e hulumtimit të lartpërmendur, janë bazuar në bashkëpunimin me tre komuna të përzgjedhura, aktivitetet e KLP të cilave u monitoruan dhe analizuan, të cilave më pas iu ofrua mbështetje dhe drejtim nga ekspertët për të përmirësuar punën e tyre. Më 11 nëntor 2022 është publikuar thirrje e hapur për aplikim nga komunat e interesuara, ku kishte 34 aplikime.

Profili i komunave që zgjodhëm për zbatimin e aktiviteteve të projektit përbëhej nga disa karakteristika. Së pari, nevojiteshin komuna me nivele të ndryshme të funksionimit të KLP:

- Komunë që ka KLP aktive dhe funksionale;
- Komunë që ka KLP të themeluar por joaktive (përkufizimi i KLP të themeluar por joaktive nënkupton që nuk ka pasur aktivitete në 6 muajt e fundit ose më shumë);
- Komunë që nuk ka formuar KLP.

Për më tepër, karakteristikat e mëposhtme të komunave ishin gjithashtu të rëndësishme për ne:

- Pozicioni gjeografik i komunës (përpyekja për të përzgjedhur komuna nga rajone të ndryshme statistikore të vendit) dhe
- Struktura demografike-etnike e komunës (përpyekje për të zgjedhur komuna më të mëdha dhe më të vogla me strukturë të ndryshme etnike)

Si rezultat, tre komunat e përzgjedhura ishin: komuna e Gostivarit, komuna e Kisella Vodës dhe komuna e Strumicës. Me to janë nënshkruar memorandume bashkëpunimi, në bazë të të cilave ka vazhduar realizimi i aktiviteteve të projektit.

Hulumtimi i mendimit publik në këto tre komuna

Si pjesë e aktiviteteve të projektit, ishte paraparë të kryhet hulumtim i mendimit publik të qytetarëve lokal në të tre komunat lidhur me qëndrimet dhe perceptimet e tyre për sigurinë lokale. Hulumtimi ka qenë në formë të anketës telefonike të ku janë anketuar njerëz nga territori i tre komunave. Pyetjet e hulumtimit janë hartuar në bashkëpunim me përfaqësuesit komunal lokal dhe kanë mbuluar fushat tematike si në vijim:

- Qëndrimet lidhur me perceptimin/ndjesinë e sigurisë;
- Qëndrimet për problemet në komunë;
- Vlerësimi i rreziqeve të sigurisë;
- Qëndrimet për qasjen dhe efikasitetin e shërbimeve urgjente në komunë;
- Qëndrimet për prioritetet kryesore në komunë;
- Qëndrimet për policinë në komunë;
- Pritjet nga komuna.

Rezultatet e hulumtimit kishin për qëllim sigurimin e informacioneve cilësore dhe të besueshme për mendimin e publikut lokal dhe për gjendjen e sigurisë në komunë, dhe në këtë mënyrë të paraqesin bazë për hartimin e mëtejshëm të problemeve dhe planifikimin e punës së KLP.

Mbikëqyrja e seancave të KLP në Gostivar, Kisella Vodë dhe Strumicë

Ekipi i projektit mori pjesë në të gjitha seancat e këshillave lokale për parandalim në të tre komunat gjatë periudhës së zbatimit të projektit dhe realizoi kontakte të rregullta me anëtarët drejtues të KLP për të mbledhur informacione dhe për t'i nxitur dhe udhëzuar në punën e tyre.

Strumicë

KLP i komunës së Strumicës është themeluar në vitin 2008. Gjatë kohëzgjatjes së projektit janë mbajtur tre seanca të këtij këshilli, në shkurt, prill dhe gusht 2022. Temat që u shqyrtuan në këto takime ishin: prerja e paligjshme dhe tregtimi i drurëve në pjesën e komunës së Strumicës, helmimi i qenve lokal, makinat për prerjen e pyjeve dhe prania e tyre në rrugët e komunës, lypja nga të miturit në rrugët e qytetit dhe tema nga fusha e arsimit. Komuna e Strumicës së fundi u bë anëtare e Rrjetit të qyteteve të fuqishme (Strong Cities Network: <https://strongcitiesnetwork.org/>)- rrjet i pavarur global i qyteteve, i dedikuar për adresimin e problemeve të urrejtjes, ekstremizmit dhe polarizimit në nivel lokal.⁵

Kisella Vodë

Komuna e Kisella Vodës themeloi këshillin e saj në vitin 2022 (disa muaj para zbatimit të aktiviteteve të projektit) dhe ishte ende në fazën e hershme të zhvillimit. Gjatë kohëzgjatjes së aktiviteteve të projektit janë mbajtur tre takime të KLP. Takimi i parë ishte themelues kurse i dyti iu kushtua dhunës së moshatarëve në shkollë. Në takimin e tretë u bisedua për vendosjen e bashkëpunimit me komunën e Studeniçanit dhe përmirësimin e parandalimit në disa fusha me interes të përbashkët në të dyja komunat.⁶

Gostivar

Në Gostivar seanca e parë e KLP u mbajt në kuadër të kohëzgjatjes së aktiviteteve të projektit, ku ekipi i projektit ishte i pranishëm dhe ndiqte punën e mbledhjes themeluese. Në Këshillin e parë lokal të parandalimit u diskutuan sfidat dhe problemet me të cilat ballafaqohet komuna gjatë periudhës së verës gjatë kthimit të emigrantëve në vendlindjen e tyre. Është bërë plan për përballimin e bllokimit të trafikut dhe janë biseduar probleme të tjera, zgjidhja e të cilave është në interes të komunës dhe qytetarëve të Gostivarit. Komuna e Gostivarit është anëtare e Rrjetit të qyteteve të forta.⁷

GJETJET DHE LEKSIONET E MËSUARA

Nëpërmjet aktiviteteve të ndërmarra të projektit dhe përmes komunikimit me përfaqësuesit komunal, ekipi i projektit ka identifikuar disa dobësi në funksionimin e këshillave lokale dhe në rregullimin strukturor të tyre. Ato mund të identifikohen në disa kategori të përkufizuara:

- mungesa e burimeve për punë;
- mungesa e mekanizmave të standardizuar të punës së brendshme;
- nevoja për përforcimin e bashkëpunimit ndërinstitutional;
- dukshmëri e pamjaftueshme e punës dhe rezultateve të arritura nga KLP, njohja e pamjaftueshme e rolit të KLP në publikun lokal.

Bazuar në këto njohuri, kemi formuluar pako të “Leksioneve të mësuara”, në të cilën përpiqemi të ofrojmë ide dhe udhëzime për të kapërcyer dobësitë e zakonshme të identifikuara të KLP.

NDARJA E MJETEVE BUXHETORE

Një nga arsyet më të rëndësishme të moszbatimit të punës së këshillave lokale për parandalim është mungesa e mbështetjes financiare nga komuna, e cila do të rriste ndjeshëm cilësinë e punës së tyre dhe motivimin për angazhimin e anëtarëve të këshillave. Sigurimi i normave buxhetore të dedikuara për punën e KLP gjithashtu do të ndihmonte që ky organ të përshtatet më mirë në strukturën më të madhe të komunës dhe do të siguronte koordinim më të mirë të aktiviteteve ndërmjet KLP dhe komunës.

Sipas njohurive tona, aktualisht asnjë KLP në Maqedoninë e Veriut nuk ka siguruar mjete financiare nga komuna. Normat e buxhetit do të mbulonin kompensimin për ekipin organizativ dhe honorarët për anëtarët e përhershëm dhe të përkohshëm të KLP kurse KLP duhet të kërkojë nga komuna financimin e projekteve dhe aktiviteteve për të cilat vendoset në të. Është e rëndësishme që KLP të marrë pjesë në përgatitjen e projekt-buxhetit për vitin e ardhshëm dhe të bëjë propozime në diskutimin e buxhetit për projekte specifike për parandalim dhe siguri.

Nëse në planet strategjike komuna nuk ka përfshirë projektet që pasqyrojnë segmentet e sigurisë në komunitet, atëherë është obligim i anëtarëve të KLP që t'i kërkojnë komunës përfshirjen e tyre në projektet dhe strategjitë buxhetore afatshkurtra dhe afatgjata gjegjësisht plane veprimi të miratuara nga komuna. Në fundi, rekomandohet që KLP të ketë të drejtë të kërkojë financim të jashtëm për projektet e saj.

UDHËHEQJA E KLP

(rolet e kryetarit të komunës dhe koordinatorit të KLP)

Gjatë monitorimit të seancave të KLP u theksua një faktor kyç për funksionimin dhe bashkimin e suksesshëm të palëve të ndryshme të pranishme- prania dhe aktiviteti i kryetarit të komunës. Kjo tregon rëndësinë e ekzistimit të një figure bashkuese të autoritetit, interesi dhe angazhimi i së cilës do të motivojë dhe fokusojë palët e pranishme që ta marrin seriozisht diskutimin e temave të caktuara. Kryetari tërheq gjithashtu besimin e palëve të interesuara se ajo që është vendosur do të zbatohet realisht dhe se zëri dhe përpjekjet e tyre nuk do të jenë të kota dhe të shpërfillura. Në realitet, komunat janë organizata shumë të centralizuara ku të gjitha nismat, projektet dhe aktivitetet e ndërmarra bazohen në theksimin e qartë të kryetarit. Prandaj, përfaqësimi i tij për zgjidhjen e çështjeve të sigurisë lokale ka rëndësi të madhe. Gjithashtu, ky rol do t'i sigurojë kryetarit të komunës informacione dhe njohuri të vlefshme për çështjet me rëndësi për qytetarët vendor, mbi funksionimin e komunitetit nga nivelet më të ulëta e më lart, mbi faktorët sistematik që e përbëjnë atë komunitet dhe marrëdhëniet e tyre të ndërsjella. Megjithatë, është thelbësore të theksohet se kjo domosdoshmëri dhe dukshmëri e figurës së kryetarit nuk do të thotë se ai është elementi “në krye të piramidës së KLP” dhe ai që duhet të marrë vendimet, por se ai është vetëm një nga hallkat që plotëson zinxhirin e institucioneve të lidhura. Ai duhet ta shtyjë pak mekanizmin e KLP, që funksionon përmes procedurave dhe teknikave të përcaktuara. Për më tepër, prania e tij kontribuon në vazhdimësinë strukturore të mekanizmit.

Përveç kryetarit si figurë drejtuese e KLP, rolin e dytë të rëndësishëm e ka edhe koordinatori i këshillit lokal, i cili në fakt është ai që bën “hapin e rëndë” më të madh në punën e KLP. Ai koncepton dhe në kuptimin praktik organizon ngjarjen: sjelljen dhe koordinimin e përfaqësuesve të palëve të interesuara, duke mundësuar diskutim të frytshëm dhe të barabartë, sigurimin e kohezionit dhe bashkëpunimit midis palëve të interesuara, formimin e grupeve tematike për diskutim, iniciimin e teknikave për analizë dhe vendimmarrje, zhvillim në kohë të fazave të planifikimit, vendimmarrjes dhe zbatimit. Përvojat nga vendet fqinje kanë treguar se këshillat që kanë koordinatori i organizojnë më mirë dhe më me sukses aktivitetet e tyre. Honorari i caktuar për koordinatori mund t'i mundësojë atij të merret me këtë fushë në baza ditore dhe të vazhdueshme dhe të thellojë kontaktet lokale, nacionale dhe ndërkombëtare.⁸

Dobësia e parë e vërejtur në rolin e koordinatori është se atij shpesh nuk i sigurohet strukturë ndihmëse nga bashkëpunëtorët, të cilëve mund t'u delegojë një pjesë të vëllimit të punës. Organizimi i takimeve të KLP përfshin investimin e kohës në punën organizative dhe marrëdhëniet njerëzore kurse meqenëse koordinatori është i angazhuar njëkohësisht në punë të tjera në komunë, ai ka vështirësi të përkushtohet plotësisht. Rekomandohet që në buxhetin komunal të ndahen mjete që do të mundësojnë angazhimin e dy asistentëve të tjerë.

Dobësia e dytë e zakonshme është mungesa e trajnimit dhe përvojës së tij në rolin e moderatorit të diskutimit, për shkak të së cilës diskutimet zhvillohen spontanisht dhe në mënyrë të pakontrolluar degëzohen në drejtime shpesh të palidhura. Linja të tilla të ndryshme të zhvillimit të diskutimit moderatorit nuk arrin t'i bashkojë dhe t'i përqendrojë qëllimisht për të rezultuar në njohuri të përdorshme dhe sugjerime praktike për progres në analizë dhe zgjidhjen e problemit.

Duhet përmendur se shpesh koordinatori i KLP është personi përgjegjës për drejtimin e seancave. Shumë shpesh mungesa e një figure me autoritet më të lartë si kryetari i komunës apo kryetari i këshillit bashkiak, e kombinuar me mungesën e rregullores së punës për KLP, rezulton në humbjen e momentit apo forcës për të adresuar disa çështje dhe probleme që janë objekt diskutimi në seancat e KLP. Koordinatori, si më i dituri në mekanizmat teknik të funksionimit të KLP, duhet të përpiqet të udhëheqë procesin dhe në të njëjtën kohë të përpiqet t'u japë zë të njëjtë të gjitha palëve dhe institucioneve të pranishme kurse në të njëjtën kohë t'i drejtojë kapacitetet e tyre dhe kompetencat për zgjidhjen e çështjeve. Prania e njërit prej drejtuesve në komunë do ta plotësonte këtë proces dhe do të çonte në rritjen e probabilitetit që një problem apo sfidë të adresohet me shpejtësi nga institucionet përkatëse.

FORMIMI I GRUPEVE PUNUESE TEMATIKE

Përveç këshillit të përbashkët në të cilin janë anëtarë të përhershëm të KLP-së, praktikë shumë efektive është formimi i grupeve punuese tematike/problematike. Këto grupe formohen kur ka një ose më shumë probleme individuale përpara këshillit që kërkojnë nivel të caktuar përvojë dhe ekspertizë dhe që duhet të shqyrtohen më thellësisht. Grupet tematike të punës përbëhen nga përfaqësues të njësive të ndryshme organizative të policisë, pushtetit lokal dhe aktorëve të tjerë të interesuar në komunitet, me detyrë që t'i definojnë problemet e sigurisë në fushën specifike të interesit të bashkësisë lokale dhe të propozojnë plane veprimi për veprime parandaluese dhe represive, të cilat përcaktojnë qartë qasjen ndaj problemit të caktuar.

Jo çdo Këshill Lokal i Parandalimit në çdo komunë duhet të ndahet në të njëjtat grupe pune. Në komuna të ndryshme, grupet punuese tematike/problematike të Këshillit Lokal për Parandalim do të varen nga karakteristikat e komunës, por edhe nga agjenda e përcaktuar për seancën e KLP-së. Praktika e formimit të grupeve tematike të punës për çështje të caktuara veçanërisht thekson përparësinë e KLP-së, e cila përbëhet nga puna e drejtuar e ekspertëve në një fushë të caktuar. Këto grupe punuese takohen jashtë seancave të parapara rregullisht të KLP-së.

BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE BRENDA-INSTITUICIONAL

Bashkësia e sigurtë lokale nënkupton koordinimin dhe proaktivitetin e subjekteve të ndryshme shoqërore, me qëllim për të adresuar në thelb natyrën komplekse të problemeve lokale që ata i shqyrtojnë. Zhvillimi i partneriteteve që do të dallohen nga afatgjatësia, besimi, kreativiteti, transparenca, përgjegjësia dhe ndërgjegjja në punë ndikon në thelb në efektivitetin dhe vullnetin e aktorëve në komunitet dhe inkurajon punën demokratike dhe zhvillimin e idealeve e parimeve demokratike. Në të njëjtën kohë, qasja e komunikimit është kyçe këtu, d.m.th. shkëmbimi i informacionit dhe përvojave në favor të një qasjeje parandaluese ndaj problemeve; gatishmëria për të ndarë burime për t'u marrë me problemet në kuadër të vendimeve të miratuara së bashku në mënyrë që të sintetizohet një qasje ndërvepruese e palëve të interesuara; dhe tejkalimin e mospajtimeve partiake dhe personale në dobi të punës së suksesshme të KLP-së për përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitet. Fatkeqësisht, cilësia e bashkëpunimit ndërinstitucional varet shumë nga marrëdhëniet personale ndërmjet përfaqësuesve të pushtetit lokal dhe institucioneve, pra nga situata aktuale politike në komunë apo qytet.

Për të siguruar marrëdhënie të qëndrueshme, është e dobishme të krijohen struktura dhe mekanizma që do të sigurojnë përgjegjshmëri dhe përgjegjësi të palëve të përfshira. Memorandumi i bashkëpunimit shpeshherë është hapi i parë drejt bashkëpunimit ndërmjet komunave dhe institucioneve, si një deklaratë jodetyruese e dëshirës dhe gatishmërisë për bashkëpunim dhe si bazë për avancimin dhe evoluimin e mëtejshëm të marrëdhënieve. Memorandumi rekomandohet të përfshijë përcaktimin e praktikave të bashkëpunimit si: shkëmbimi i informacionit, ndërmarrja e përbashkët e aktiviteteve, ndarja e burimeve njerëzore përkatëse, përcaktimi i mekanizmave të fidbek-ut, etj. Forma të tjera të bashkëpunimit me institucionet janë pjesëmarrja në formulimin e strategjive lokale dhe dokumenteve strategjike, krijimi i klasterëve dhe organizatave kontaktuese për zbatimin e strategjive individuale dhe kontraktimi i shërbimeve.⁹

Mekanizmi më efektiv për arritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional është padyshim sigurimi i detyrimit ligjor për funksionimin e KLP-së me mekanizma për angazhim aktiv të të gjitha palëve të interesuara, i cili do të rregullohej dhe vendosej lehtësisht dhe shpejt përmes ndërhyrjes në Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale.

ZHVILLIMI I RREGULLORES SË PUNËS

Përzgjedhja e anëtarëve dhe takimi i tyre nuk mjafton për të siguruar punën efikase të KLP-së nëse nuk ka procedurë të standardizuar për punën e këtij organi. Disa nga fushat që rregullorja duhet t'i përcaktojë janë: qëllimi i punës së KLP-së; mënyrat e komunikimit ndërmjet anëtarëve të KLP-së, si dhe me publikun; formatin dhe modelet e vendimmarrjes; mënyrën e përzgjedhjes së anëtarëve dhe ekipit organizativ; rolet e komunës dhe palëve të tjera të interesuara dhe mekanizmat e transparencës dhe llogaridhënies së KLP-së.

Përveç kësaj, KLP duhet të punojë në bazë të dokumenteve të tjera të krijuara nga njësitë e vetëqeverisjes lokale, si: lloje të ndryshme të strategjive tematike dhe planeve të punës, strategjia e komunikimit, buxheti vjetor i komunës etj.

DUKSHMËRIA DHE KOMUNIKIMI

Informimi i qytetarëve lokal është parakusht për realizimin e formave të tjera të pjesëmarrjes së publikut në punën e KLP-së. Qëllimi i komunikimit me publikun është ngritja e vetëdijes dhe përkrahja për punën e KLP-së dhe kontributi aktiv i publikut në punën e saj. Duke vepruar kështu, është e rëndësishme të përcaktohen: lloji i informacionit që do të transmetohet, grupi i synuar, mënyra/forma e transmetimit të informacionit si dhe matja e ndikimit të informacionit të publikuar. Nuk duhet neglizhuar komunikimi i rregullt dhe proaktiv me institucionet që janë palë të interesuara në punën e KLP-së, me definimin konkret të mekanizmave për komunikim dhe informim.

Është shumë e rëndësishme mundësia për njohuri publike për temat e shqyrtuara nga KLP-ja dhe vendimet e marra. Mbledhjet e planifikuara të KLP-së, përbërja e anëtarëve dhe temat që do të diskutohen, si dhe njoftimet e opinionit për rrjedhën e diskutimeve, mendimet e shkëmbyera dhe vendimet e marra, duhet të raportohen me kohë. Informacionet e këtilla duhet të komunikohen përmes kanaleve të komunës, kanaleve të institucioneve të përfaqësuara në përbërje të KLP-së dhe përmes mediave lokale.

Përveç informimit, i cili është mekanizëm i njëanshëm për komunikim me publikun, KLP-ja mund të përdorë edhe mekanizma në nivel më të lartë për të përfshirë qytetarët dhe aktorët e tjerë lokalë në punën e saj. Dialogu me qytetarët mund të realizohet përmes konferencave për media, paneleve të diskutimit, debateve publike, takimeve etj. Konsultimet janë një formë e pjesëmarrjes në të cilën KLP kërkon informacion, mendim, komente, këshilla ose të ngjashme nga komuniteti në lidhje me çështje specifike. Partneriteti është forma më e lartë e pjesëmarrjes së aktorëve vendorë në proceset vendimmarrëse dhe nënkupton pjesëmarrjen e tyre në të gjitha fazat e procesit të vendimmarrjes.

MATRICA ME INDIKATORË TË VETËVLERËSIMIT PËR PUNËN E KËSHILLAVE LOKALE PËR PARANDALIM

Në fazat e fundit të projektit është përpunuar një matricë me indikatorë për punën e këshillave lokale për parandalim, e cila duhet të shërbejë si udhërrëfyes dhe mjet për vetëvlerësimin e KLP-së. Indikatorët u zhvilluan në bazë të njohurive nga monitorimi dhe analiza e seancave të KLP-së, si dhe përmes bisedave me anëtarët e KLP-së.

Indikatorët ndahen në tre grupe:

- funksionaliteti - i referohet aspekteve të mënyrës se si funksionon KLP;
- dukshmëria dhe përfshirja e komunitetit - i referohet marrëdhënies së KLP me publikun;
- efektiviteti - indikatorët për matjen e rezultateve të punës së KLP.

INDIKATORËT E FUNKSIONALITETIT, DUKSHMËRISË DHE EFIKASITETIT NË PUNËN E KLP-SË**FUNKSIONALITETI**

1	KLP mban seanca të rregullta të paktën një herë në dy muaj
2	Me vendim të kryetarit të komunës është caktuar ekipi administrativo-koordinues i KLP
3	Prezenca e kryetarit të komunës në seancat e KLP
4	Prezenca e këshilltarëve komunalë në seancat e KLP
5	Prezenca e përfaqësuesve nga SPB rajonale në seancat e KLP
6	Grupet tematike të punës formohen për të shqyrtuar dhe trajtuar temat dhe problemet individuale të identifikuara nga KLP
7	Mjetet e buxhetuara në buxhetin komunal që janë të dedikuara për funksionimin e KLP-së
8	KLP i paraqet raport këshillit komunal lidhur me realizimin e seancave dhe rezultatet e arritura

DUKSHMËRIA DHE PËRFSHIRJA E KOMUNITETIT

9	Në faqen e internetit dhe rrjetet sociale të komunës, rregullisht publikohen njoftime për seancat e KLP si dhe informacione për rolin dhe kompetencën e KLP.
10	Raportet/procesverbalet nga seancat e KLP publikohen rregullisht në faqen e internetit dhe rrjetet sociale të komunës
11	Ekziston një mekanizëm që qytetarët të propozojnë tema për shqyrtim të KLP
12	Mediat lokale e ndjekin punën e KLP

EFEKTIVITETI

13	Numri i veprimeve të ndërmarra pas përfundimit të KLP
14	Vlerësimi periodik i aktiviteteve të realizuara pas përfundimit të KLP
15	Cilësia e shërbimit: shkalla në të cilën aktivitetet e ndërmarra plotësojnë nevojat dhe pritshmëritë e popullatës lokale
16	Ndryshimet në politikat/procedurat lokale si rezultat i veprimeve të KLP
17	Përmirësimi i sigurisë lokale si rezultat i veprimeve të KLP
18	Ekziston një mekanizëm për ndjekje/fidbek nga anëtarët e KLP për aktivitetet që janë vendosur të realizohen.
19	Mbulimi: përqindja e popullsisë së synuar që është prekur nga veprimet e ndërmarra pas vendimit të KLP-së
20	Pjesëmarrja: përqindja e popullsisë së synuar që mori pjesë në aktivitetet e KLP
21	KLP angazhohet në zgjidhjen e problemeve afatgjata dhe komplekse nëpërmjet përcaktimit të strategjive dhe politikave

KONKLUZIONI

Këshillat Lokale për Parandalim (KLP) paraqesin mjet kryesor në zinxhirin e mekanizmave për menaxhimin efektiv të problemeve dhe sfidave lokale komunale, të sigurisë dhe të tjera të përditshme, por edhe një mjet për punën policore efektive demokratike. Karakteristikat kryesore të tyre janë fokusi në aktivitetet parandaluese dhe baza e një qasjeje multiperspektive që përfshin të gjithë aktorët lokalë. Sistemi i krijuar me sukses i KLP ka potencial të madh për rritjen e besimit të qytetarëve në pushtetin lokal dhe policinë.

Përkundër përpjekjeve afatgjata për themelimin e KLP nëpër komuna, koncepti është ende në margjinat e aktiviteteve të autoriteteve lokale dhe interesimi për zhvillimin e tij është i ulët. Autorët e këtij publikimi pengesën kryesore në zbatimin e KLP e shohin në mungesën e një strukture mundësuese për themelimin e KLP në të gjitha komunat dhe vendosjen e tyre në baza vullnetare. Prej aty, formimi dhe funksionimi aktiv i KLP është i domosdoshëm që të rregullohet në legjislacionin nacional si një detyrim, në vend të vetëm si mundësi, për autoritetet lokale, me mekanizma për angazhimin aktiv të të gjitha palëve të interesuara. Kjo do të ishte më e lehtë dhe më e shpejtë e rregulluar dhe e vendosur përmes ndërhyrjes në Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale. Ky proces duhet të fillojë me veprime të drejtpërdrejta dhe hapa të ndërmarrë nga të gjithë aktorët e interesuar shoqërorë, në mënyrë që të ngrihet niveli i bashkëpunimit të ndërsjellë, i cili duhet të synojë zgjidhjen e sfidave të sigurisë lokale dhe problemeve dhe çështjeve të tjera.

REFERENCAT

¹ Këshilli Lokal për Parandalim, Shkup, 2018, fq. 8 [https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/Local-Prevention-Council-Final%20\(1\).pdf](https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/Local-Prevention-Council-Final%20(1).pdf)

² Ligji për Policinë, Shkup, 2015 fq.4, <https://www.mvr.gov.mk/Upload/Documents/Zakon%20za%20policija,%20precisten%20tekst%2015.04.2015%20.pdf>

³ Stojanovski, A. Angelevska, K. Nikollovski, D. “Përfshirja në vendimmarrje në punën e policisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, Eurothink - Qendra për Strategji Europiane, 2023

⁴ Stojanovski, A. Nikollovski, D. “Perceptimet dhe qëndrimet e qytetarëve për punën e policisë”, Eurothink – Qendra për Strategji Europiane, 2022, <http://eurothink.mk/wp-content/uploads/2023/07/Perceci-i-stavovi-na-graganite-za-rabotata-na-policijata-2022.pdf>

⁵ Publikime në faqen e internetit të komunës së Strumicës për seancat e KLP:

- <https://shorturl.at/bFGQ9>
- <https://shorturl.at/oOQT9>
- <https://shorturl.at/byMV8>

⁶ Publikime në faqen e internetit të komunës së Kisella Vodës për seancat e KLP:


- <https://www.kiselavoda.gov.mk/index.php/naslovna/novosti/3458-2022-10-26-12-19-44>
- <https://www.kiselavoda.gov.mk/index.php/naslovna/novosti/3585-2023-04-07-11-42-22>

⁷ Publikime në faqen e internetit të komunës së Gostivarit për seancat e KLP:

- <https://t.ly/imq4P>
- <https://t.ly/Y1kJb>

⁸ Burimi: Bjelos, M., Brozovic, Z., Djordjevic, S., Prirucnik za rad lokalnih saveta za bezbednost, beogradski centar za bezbednosnu politiku

⁹ Bjelos, M. etj. “Prirucnik za rad lokalnih saveta za bezbenost”, Centar za podršku ženama iz Kikinde, 2011



Ky projekt mbështetet nga Ambasada e ShBA-së. Mendimet, gjetjet dhe konkluzionet ose rekomandimet e shprehura këtu janë të zbatuesve/autorëve dhe nuk i pasqyrojnë ato të Qeverisë së ShBA-së.

